



DREJTORIA E PROGRAMEVE NDËRKOMBËTARE

SEKTORI I MARRËDHËNIEVE DY-PALËSHE

PYETJE- PËRGJIGJE TË SHPESHTA PËR PROJEKTET BILATERALE (FAQ):

*Për më shumë detaje, lexoni udhëzuesin që do të publikohet në cdo thirrje

1. Kush mund të aplikojë në thirrjet për projekt-propozime bilaterale pranë AKKSHI?

Çdo person juridik (**publik ose privat**) që ka si objekt në statusin e tij **kërkimin shkencor** mund të aplikojë duke dërguar një projekt-propozim **në kuadër të thirrjeve bilaterale**.

2. Çfarë dokumentash nevojiten për aplikim në thirrjet bilaterale të AKKSHI?

a- 3(tri) kopje të **projekt-propozimit në shqip**;

b- 3(tri) kopje të **projekt-propozimit në anglisht**;

*Në thirrjet bilaterale Shqipëri-Kosovë nuk do të jetë e nevojshme.

c- 3(tri) kopje të **jetëshkrimit** nga të dy drejtuesit e projektit;

*Në thirrjet ku do të jetë e parashikuar, do të kërkohen edhe cv për secilin anëtar të të dyja grupeve të punës.

d- 1(një) **shkresë përcjellëse nga Rektori (IAL)/ titullari i institucionit (OJF, etj)**;

Sqarim: *Projekt-propozimi duhet të nënshkruhet me **firma origjinale nga të dy drejtuesit**.

** Në formularin që do të plotësohet, shuma e vendosur duhet të jetë **në lekë dhe në euro sipas kursit të këmbimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, duke u bazuar në datën (duke nga dërguar dhe evidencën përkatëse të bashkëngjitur) në të cilën do të plotësoni dokumentat e nevojshme për aplikim**.

c- 1(një) **kopje elektronike (CD) e të gjithë dokumentave të cituara më sipër**;

3. Cili është qëllimi i grantit?

Të financoi mobilitetin e kërkuesëve (edhe zëra të tjerë specifik, në rastet ku parashikohet, duke u mbështetur në Protokollin e Bashkëpunimit), të cilët do të aplikojnë me një projekt-propozim të përbashkët në thirrjet e shpallura nga AKKSHI, me qëllimin për të nxitur bashkëpunimin shkencor midis dy vendeve.

4. Cili është sektori përgjegjës për marrëveshjet bilaterale?

Sektori i Marrëdhënieve Bilaterale, pranë AKKSHI është ai i cili harton, negocion dhe sigurohet për implementimin e marrëveshjeve bilaterale me institucionet homologe në vendet e tjera.



5. Cilat janë afatet e aplikimit dhe frekuencat e thirrjeve?

Hapja e thirrjeve dhe **afati** për kohëzgjatjen e tyre vendosen **mbi bazën e marrëveshjes me institucionet homologe dhe janë të ndryshme për çdo marrëveshje.**

6. Sa është masa e financimit vjetor për projektet bilaterale?

Masa e financimit **caktohet me marrëveshje me institucionet homologe me AKKSHI dhe është e ndryshme për çdo marrëveshje.**

7. Cilat janë institucionet që financojnë projektet bilaterale?

Shpenzimet për kërkuesit shqiptarë mbulohen nga AKKSHI. Shpenzimet për kërkuesit e huaj mbulohen nga institucioni homolog me AKKSHI.

8. A mund të bëjnë pjesë te grupi i kërkimit shqiptar kërkues të huaj?

Nëse pjesëmarrja e kërkuesve të huaj nuk prodhon kosto financiare për projektin, po. Fondet publike që AKKSHI alokon për kërkim, synojnë të financojnë kërkuesit shqiptarë të cilët janë pjesë e institucionit përfitues.

9. A lejohen pjesëmarrës nga institucione të tjera te grupi i punës në një projekt-propozim?

Lejohen, por nuk mund të kryhen shpenzime nga granti i dhënë në emër të tyre.
* Më shumë detaje do të specifikohen në udhëzuesin e sektorit.

10. Cilat janë kostot e lejuara?

a- Kostot që lidhen me **mobilitetin (transporti, dieta, akomodimi):**

a1- Për udhëtimet brenda vendit: transport publik interurban; akomodimi- i cili lejohet **vetëm sipas specifikimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi (pika 11)** dhe dietat ditore **të përlogaritura në bazë të titullit/funksionit** të cdo pjesëmarrësi (pika 11);

a2- Për udhëtimet jashtë vendit: avion, traget, autobus, shpenzime transporti nga aeroporti në hotel dhe anasjelltas (ku lejohet dhe përdorimi i taksisë); akomodimi- i cili lejohet **vetëm sipas specifikimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi (pika 11)** dhe dietat ditore **të përlogaritura në bazë të titullit/funksionit** të cdo pjesëmarrësi (pika 11);

b- Kosto për publikimin e rezultateve të kërkimit: Lejohen shpenzime për publikime vetëm në revista me faktor impakti, të indeksuara në një nga platformat në vijim: "Scopus", "Research Gate", "Web of Science" etj;

***Ky zë është i lejueshëm vetëm në thirrjet ku do të parashikohet në mënyrë specifike, duke u mbështetur në Protokollin e Bashkëpunimit.**

c- Mjete laboratorike (provëza, veshje laboratorike, kite, reagent, etj)

***Ky zë është i lejueshëm vetëm në thirrjet ku do të parashikohet në mënyrë specifike, duke u mbështetur në Protokollin e Bashkëpunimit.**



d- Cdo zë tjetër që do të mbështetet nga **Protokolli i Bashkëpunimit** dhe **do të publikohet në thirrje;**

11. Cila është baza ligjore që duhet ti përmbahet grupi i punës kur përdor grantin?

a- Për udhëtimet brenda vendit, cdo shpenzim do të realizohet bazuar në VKM nr. 997 datë 10.12.2010 dhe VKM 146, datë 26.02.1998;

b- Për udhëtimet jashtë vendit, cdo shpenzim do të realizohet duke ju referuar VKM nr.870, datë 14.12.2011 dhe Udhëzimit nr.22, datë 10.07.2013;

c- Dietat do të llogariten sipas Vendimit nr.870, datë 14.12.2011 dhe udhëzimit nr.22, datë 10.07.2013, Vendimi Nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit" (Ndryshuar me VKM nr.813 datë 21.11.2012, me VKM nr.558 datë 3.07.2013, me VKM nr.617 datë 24.07.2013, me VKM nr.6 datë 8.01.2014, me VKM nr.329 datë 20.04.2016, nr. 130, datë 7.3.2018), duke llogaritur këto të fundit sipas titullit që ka çdo pjesëmarrës;

d- Akomodimi: vendqëndrimi duhet të përzgjidhet sipas VKM nr.870, datë 14.12.2011, pika 9;

Etj;

12. Cilat kosto janë të palejueshme?

a- Kostot për pajisje dhe aparatura që lidhen me kërkimin. (Aplikantët duhet të përdorin aparaturat dhe materialet ekzistuese nëpër institucionet aplikuese të të dyja palëve ose mund të përdorin fonde shtesë nga aktorë të tjerë për blerjen e tyre.)

b- Shpenzime për karburant;

c- Shpenzime për makina me qira, shpenzime për taksi (përvec rasteve të lejuara, pika **10- a2**);

d- Kosto personeli, honorare;

e- Kosto për pjesëmarrës të tjerë që janë (ose jo) pjesë e grupit të punës por nuk janë të punësuar pranë institucionit përfitues;

f- Kosto për udhëtime në vende të treta që nuk ndërlidhen me projektin; nuk kanë qënë të parashikuara në projekt-propozim dhe nuk kanë marrë miratimin paraprak nga AKKSHI dhe pala tjetër në kuadër të thirrjes bilaterale; (Për më shumë detaje, shih **pika 13**);

g- Shpenzime për pritje/përcjellje (për dreka ose darka);

h- Shpenzime për materiale promovuese, si banera, fletëpalosje, etj;

j- Shpenzime transporti brenda qytetit (brenda dhe jashtë vendit);

i- Cdo zë tjetër i cili nuk është në përputhje me Protokollin e Bashkëpunimit, legjislacionin në fuqi dhe në kundërshtim me udhëzimet dhe kontratën e lidhur me AKKSHI;



13. A lejohen udhëtimet në vende të treta?

a- Po, në rast se janë të parashikuara dhe shpjeguar në mënyrë të qartë në projekt-propozim dhe janë të domosdoshme për arsye të mungesës së infrastrukturës në të dy vendet e thirrjes (si psh: laborator, arkiva, etj) që janë thelbësore në arritjen e objektivave të projektit.

b- Jo, në asnjë rast kur informacioni nuk është i qartë; i padetajuar; i pashtjelluar dhe lë vend për interpretim. Në këtë rast Ekspertët e Jashtëm Vlerësues dhe/apo stafi i AKKSHI i lind e drejta të deduktojnë se të gjithë aktivitetet e parashikuara do të zhvillohen në dy vendet e thirrjes bilaterale.

*Sqarim: Qëllimi kryesor i mobilitetit brenda thirrjeve bilaterale është inkurajimi i vizitave të shkëmbyera në vendet ku është shpallur thirrja.

14. A mund të kërkoj financim shtesë nga palë të treta?

Po, të gjitha format e ligjshme të financimit janë të pranueshme për pjesën e kostove/zërave të cilat nuk mbulohen nga AKKSHI.

15. A mund të marrë pjesë në një thirrje të re si drejtues projekti edhe në rastin kur jam fitues i një thirrje të mëparshme që është duke u zbatuar?

Jo, drejtuesi i projektit duhet të angazhohet vetëm në një projekt-propozim, i cili është në proces zbatimi.

*Duke filluar nga thirrjet e ardhshme. Më shumë detaje do të specifikohen në udhëzuesin e sektorit.

16. A lejohet të aplikoj në të njëjtën thirrje me më shumë se një projekt-propozim?

Jo, drejtuesi mund të aplikoj vetëm me një projekt-propozim në cdo thirrje.

*Duke filluar nga thirrjet e ardhshme. Më shumë detaje do të specifikohen në udhëzuesin e sektorit.

17. A lejohen anëtarët e grupeve të punës të përfshihen në më shumë se një projekt-fitues?

Po, anëtarët e grupeve të punës mund të përfshihen në disa projekte.

*Më shumë detaje do të specifikohen në udhëzuesin e sektorit.

18. A lejohen titullarët e institucioneve të aplikojnë si drejtues projekti?

Jo, nuk lejohet pasi përbënë konflikt interesi.

19. A mund të kërkoj rialokim të fondeve në zëra të ndryshëm të planit të financimit?

Rast pas rasti mund të lejohet deri në **masën 10%**. **Kërkesa për rialokim bëhet nga aplikanti me shkresë zyrtare nga titullari i institucionit (Rektori për IAL) dhe po kështu, aprovimi ose refuzimi jepet nga AKKSHI me shkrim.**

20. A lejohet ndryshimi i drejtuesit të projektit apo/edhe i anëtarëve të grupit të punës?

Po, lejohet vetëm me miratim nga AKKSHI, duke na u drejtuar me shkresë zyrtare nga titullari i institucionit (Rektori për IAL).



21. A lejohet përfshirja e studentëve në grupet e punës?

Po, përfshirja lejohet dhe inkurajohet nga AKKSHI me kusht që IAL përfituese e fondit të mos disbursoj pjesë të këtij granti për qëllimet e angazhimit të këtyre studentëve.

*Shpjegim: AKKSHI disburson grantin IAL-ve dhe njih si persona përfitues (sipas kuadrit ligjor) vetëm stafin akademik brenda të njëjtës IAL.

22. A është raporti vjetor dhe përfundimtar i domosdoshëm?

Cdo drejtues projekti **duhet të plotësoj dhe dërgoj formularin me të dhënat e nevojshme për të kryer raportimin vjetor dhe përfundimtar (2 kopje)**, të shoqëruar nga **dokumentacioni financiar (2 kopje) që vërteton shpenzimet e kryera me grantin e dhënë**, në afatet e përcaktuara nga AKKSHI. Raportimi vjetor dhe përfundimtar është **detyrim kontraktual**, i cili buron nga udhëzimi Nr.1, datë 30.11.2017 “Për procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve që financohen në kuadrin e programeve të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik ndërmjet dy vendeve” dhe gjithashtu nga kontrata ndërmjet AKKSHI dhe fituesve të projekteve bilaterale.

23. Kush e kryen vlerësimin?

Vlerësimi kryhet nga grupe **Ekspertësh të Jashtëm**, që mbajnë titullin Akademik apo Profesor. Lista e Komisioneve të Ekspertëve të Vlerësimit për palën shqiptare, në bazë të fushave **miratohet nga Bordi i Administrimit i AKKSHI**. Cdo komision përbëhet nga **5 ekspertë**.

24. Si vendosen fituesit?

Fituesit vendosen në bazë të **vlerësimit të dhënë nga Komisionet e Ekspertëve të Jashtëm të të dyja vendeve**. Më pas një **Komitete i Përbashkët** me përfaqësues nga dy institucionet financuese (nga të dy vendet) **vendos metodën me të cilën do të përcaktohen fituesit duke marrë për bazë vlerësimet e ekspertëve të fushave nga të dyja vendet**.

25. Kur fillon financimi?

Pas marrjes së miratimit nga Bordi i Administrimit të AKKSHI dhe nënshkrimit të kontratave me fituesit.

26. A ka dokumenta të tjerë që do të kërkohen nga AKKSHI gjatë fazës së nënshkrimit të kontratës?

Po, gjatë fazës së nënshkrimit të kontratës, drejtuesi i projektit duhet të dorëzoj edhe **Planin e Financimit (2 kopje)** dhe **Kalendarin e Aktiviteteve (2 kopje)**, të përcaktuar sipas udhëzimeve në cdo thirrje.

27. A është detyrim publikimi i rezultateve të projekteve?

Po, publikimi i rezultateve është detyrim ligjor, i cili rrit transparencën dhe ndalon plagjiaturën.

28. Sa është kohëzgjatja e projekteve bilaterale?

Zakonisht projektet bilaterale zgjasin për **periudha dy-vjeçare**.



29. Cfarë do të ndodh me fondin e mbetur në rast se nuk përdoret e gjithë shuma e grantit?

Do të kthehet në **buxhetin e shtetit**. Për këtë arsye duhet të dërgohet edhe një **shkresë zyrtare nga titullari institucionit (Rektori për IAL)**, ku do të theksohet **kthimi i shumës së mbetur në buxhetin e shtetit nga granti i dhënë nga AKKSHI për projektin (e përfunduar) në fjalë** (bashkëngjitur së cilës do të jetë dhe **evidenca** e kthimit të shumës së mbetur).

30. Cfarë do të ndodh me grantin e dhënë në rast se projekti nuk fillon zbatimin, për shkak të tërheqjes së grupit të punës nga njëra palë ose/dhe arsye të tjera të justifikuara?

Do të kthehet në **buxhetin e shtetit**. Për këtë arsye duhet të dërgohet edhe një **shkresë zyrtare nga titullari institucionit (Rektori për IAL)**, ku do të theksohet **tërheqja nga projekti në fjalë si dhe kthimi i grantit në buxhetin e shtetit**, bashkëngjitur së cilës do të jetë dhe **evidenca** përkatëse.

31. Cili është produkti/rezultati që vërteton përfundimin e një projekti?

Kryerja e **mobiliteteve duke realizuar objektivat e parashikuara në projekt**.